Vendim nr. 299, datë 25.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 25.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (H) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **HAMDI BARDHOSHI,** përfaqësuar nga avokati Neshat Fana, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 42, datë 07.03.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2025-959 (152), datë 12.06.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 31, 32, 131, shkronja "f" dhe 134, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është proceduar penalisht në lidhje me ngjarjen e datës 10.06.1997, në të cilën ka mbetur i vrarë me armë zjarri shtetasi H.Rr., banor i fshatit Qarr, Has, i cili është gjetur

në kopshtin pranë banesës së tij. Për këtë ngjarje prokuroria ka regjistruar procedimin penal nr. 33 të vitit 1997, pa autor, i cili është pezulluar në datën 20.03.1998 për moszbulim të autorit. Në datën 21.03.2000, mbi bazën e kallëzimeve të familjarëve të viktimës, është vendosur rifillimi i hetimit, ndërsa në datën 20.04.2001 prokuroria ka disponuar përsëri pezullimin e tij. Më pas, me vendimin nr. 111, datë 19.05.2003 të Prokurorisë së Përgjithshme, është urdhëruar rifillimi i hetimeve. Në përfundim të hetimeve, kërkuesi është akuzuar për veprat penale "Vrasja me paramendim", të kryer në bashkëpunim dhe "Mbajtja pa leje e armëve shpërthyese dhe municionit", të parashikuara nga nenet 78/1 e 25 dhe 278/2 të Kodit Penal (KP).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. 90, datë 14.07.2004, ka deklaruar të pafajshëm kërkuesin për veprat penale "Vrasja me paramendim", të kryer në bashkëpunim dhe "Mbajtja pa leje e armëve shpërthyese dhe municionit", të parashikuara nga nenet 78/1 e 25 dhe 278/2 të KP-së, pasi nuk provohej që ai t'i kishte kryer veprat për të cilat akuzohej. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 59, datë 09.03.2005, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 317, datë 17.05.2006, ka prishur vendimet e të dyja gjykatave dhe ka dërguar aktet për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, me tjetër trup gjykues.

3. Pas kthimit të çështjes për rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. 41, datë 27.05.2008, ka vendosur deklarimin të pafajshëm të kërkuesit për të dyja veprat penale, pasi nuk provohej që ai t'i kishte kryer ato, bazuar në nenin 388, shkronja "d", të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Gjykata e shkallës së parë ka analizuar deklarimet e dëshmitarëve dhe provat e tjera të administruara, duke evidentuar mospërputhje ndërmjet tyre, përfshirë ato që lidheshin me rrethanat e ngjarjes dhe numrin e armëve të përdorura. Ajo gjykatë ka marrë në konsideratë edhe deklarimet e dëshmitarëve, sipas të cilëve autor i vrasjes ishte S.B., si dhe ato sipas të cilëve ditën e ngjarjes kërkuesi ndodhej në fshatin Vlahen. Në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë është kryer rindërtimi i vendit të ngjarjes në datën 04.03.2008, në kushte të ndryshme nga ato të kohës së ngjarjes, ndërsa pyetja e dëshmitarit L.Rr., djalit të viktimës, nuk është bërë e mundur, pasi ai gjendej jashtë shtetit dhe nuk dihej adresa e tij e saktë. Në përfundim, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se nuk provohej që kërkuesi të ishte autor i vrasjes.

4. Mbi ankimin e prokurorit, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 297, datë 05.11.2008, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e deklaruar kërkuesin fajtor për veprat penale "Vrasja me paramendim", të kryer në bashkëpunim, dhe "Mbajtja pa leje e armëve shpërthyese dhe municionit", duke e dënuar përfundimisht me 20 vjet burgim.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 883 (614), datë 09.06.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, si një vendim i bazuar në prova dhe në ligj.

5. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë dhe rigjykimin e çështjes, duke pretenduar se është (ri)gjykuar në mungesë dhe se në këto procese nuk ka qenë i përfaqësuar nga një avokat i zgjedhur prej tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. 124 (341), datë 13.03.2019, ka pranuar kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 297, datë 05.11.2008 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe e ka dërguar çështjen për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

6. Gjatë rigjykimit, Gjykata e Apelit Shkodër ka pezulluar gjykimin dhe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke vlerësuar se neni 453, pikat 1 dhe 3, i KPP-së binte në kundërshtim me nenin 34 të Kushtetutës. Gjykata, me vendimin nr. 3, datë 08.01.2020, ka vendosur mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke vlerësuar se gjykata referuese nuk plotësonte kriteret e legjitimimit, sipas nenit 145, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 68 të Ligjit Organik të Gjykatës.

7. Në vijim të rigjykimit, Gjykata e Apelit Shkodër, duke qenë përpara një vendimi pafajësie, në bazë të nenit 427 të KPP-së, ka vendosur përsëritjen e plotë të shqyrtimit gjyqësor. Në përfundim, me vendimin nr. 42, datë 07.03.2022, ajo ka ndryshuar vendimin nr. 41, datë 27.05.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, duke e deklaruar kërkuesin fajtor për veprën penale "Vrasja me paramendim", të parashikuar nga neni 78/2 i KP-së, dhe duke e dënuar me 20 vjet burgim, si dhe për veprën penale "Mbajtja pa leje e armëve shpërthyese dhe municionit", të parashikuar nga neni 278/2 i KP-së, duke e dënuar me 1 vit burgim. Në zbatim të nenit 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve, kërkuesi është dënuar përfundimisht me 20 vjet burgim.

8. Gjykata e apelit, në ndryshim nga sa ka arsyetuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, ka arritur në konkluzionin se akuza ndaj kërkuesit për vrasjen me paramendim në bashkëpunim të shtetasit H.Rr. mbështetet në provat e analizuara në gjykim, të cilat provojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm fajësinë e tij. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar dhe përcaktuar drejt vërtetësinë dhe fuqinë provuese të provave, në zbatim të nenit 152 të KPP-së. Gjykata e apelit ka çmuar se thëniet e dëshmitareve okulare, të cilat kanë identifikuar të pandehurin duke qëlluar me armë në drejtim të viktimës, gjejnë konfirmim në thëniet e dëshmitarëve të tjerë, si dhe në këqyrjen e vendit të ngjarjes, aktin e ekspertimit mjeko-ligjor dhe rindërtimin e vendit të ngjarjes. Duke mbajtur parasysh se ngjarja ka ndodhur ditën, në ndriçim natyral dhe në një distancë të afërt, ajo gjykatë ka çmuar se dëshmitaret kanë pasur mundësi të shihnin dhe identifikonin autorët e vrasjes. Për rrjedhojë, ajo gjykatë ka konkluduar se është provuar tej

çdo dyshimi të arsyeshëm se në datën 10.06.1997 kërkuesi, në bashkëpunim me tre persona të tjerë, në rolin e ekzekutorit, ka vrarë me armë zjarri shtetasin H.Rr. Po ashtu, gjykata e apelit ka vlerësuar se midis familjeve të kërkuesit dhe të viktimës ka pasur një hasmëri prej vitit 1992, duke çmuar se ky konflikt përbënte shkakun kryesor dhe motivin e vrasjes. Për sa i përket alibisë së të pandehurit se në kohën e ngjarjes ndodhej në fshatin Vlahen, gjykata e ka gjetur atë të pavërtetë, të pabazuar dhe të tillë që nuk mund të rrëzojë akuzën ose të ngrejë dyshime të arsyeshme mbi të, duke mbajtur parasysh se ajo nuk ishte ngritur në momentet e para të ngjarjes dhe nuk ishte përmendur në deklarimet e viteve 1997, 1998 dhe 2000. Edhe lidhur me fletën e regjistrit të mjekimeve të Qendrës Shëndetësore të fshatit Vlahen dhe deklarimet e dëshmitares K.G., në vlerësimin e gjykatës së apelit nuk kishte asnjë provë të pakundërshtueshme për të provuar se kur ishte kthyer kërkuesi në fshatin Qarr, duke konkluduar se kërkuesi, në bashkëpunim me tre persona të tjerë të paidentifikuar, ka kryer veprën penale të vrasjes me paramendim për motive gjakmarrjeje, si dhe atë të mbajtjes pa leje të armëve, duke e dënuar, në bashkim të dënimeve, me 20 vjet burgim. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs.

9. Me vendimin nr. 00-2025-959 (152), datë 12.06.2025, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 42, datë 07.03.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër. Sipas atij kolegji, gjykata e apelit në rigjykimin e çështjes ka treguar kujdesin e duhur për të garantuar të drejtat e kërkuesit, duke disponuar për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, me qëllim që ai të ballafaqohej me provat, sidomos dëshmitarët, duke i krijuar hapësirën, mundësinë dhe kohën e nevojshme për të realizuar një mbrojtje efektive. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, gjykata e apelit ka vlerësuar dhe analizuar provat në tërësinë dhe lidhjen e tyre, pa i dhënë ndonjërës vlerë të paracaktuar, në respektim të neneve 152 dhe 383 të KPP-së, të parimit të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve. Fajësia e kërkuesit nuk ishte bazuar në një provë të vetme, por në deklarimet e dëshmitarëve okularë, të vlerësuara së bashku me provat shkresore dhe shkencore dhe me indiciet e tjera, ndërsa alibia dhe provat e paraqitura nga mbrojtja ishin analizuar dhe rrëzuar në mënyrë të argumentuar. Për sa i përket së drejtës së mbrojtjes, Kolegji Penal ka vlerësuar se mbrojtësi i zgjedhur kishte paraqitur në mënyrë të përsëritur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares V.V., të cilat ishin rrëzuar si të pabazuara, duke u bërë pengesë për ecurinë e procesit, për këtë arsye sjellja e tij ishte barazuar me braktisjen *de facto* të mbrojtjes dhe gjykata e apelit kishte caktuar mbrojtës kryesisht. Sipas Kolegjit Penal, kërkuesi kishte pasur mundësi të paraqiste prova, të pyeste dëshmitarët e akuzës dhe të sillte dëshmitarë në mbështetje të alibisë së tij, ndaj mbrojtja ishte realizuar efektivisht. Në lidhje me paanshmërinë e gjykatës, ai kolegj ka vlerësuar se mosmarrëveshja e pretenduar ndërmjet

gjyqtares V.V. dhe mbrojtësit G.Y. lidhej me vendimmarrje në një çështje tjetër dhe nuk përbënte konflikt interesi ose shkak papajtueshmërie sipas nenit 17, pika 1, shkronja "ç", të KPP-së. Për rrjedhojë, ai kolegj nuk ka konstatuar zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural dhe as cenim të garancive të procesit të rregullt ligjor.

10. Në datën 13.05.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik, është regjistruar në datën 03.06.2026.

II

Pretendimet e kërkuesit

11. ***Kërkuesi*** ka pretenduar cenimin *e së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi të dyja vendimet janë marrë në shkelje të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për të drejtën e zgjedhjes së mbrojtësit nga vetë i pandehuri, vlerësimin e provave pa u dhënë vlerë të paracaktuar dhe ngritjen e akuzave sipas ligjit. Në arsyetimin e vendimit Kolegji Penal ka justifikuar plotësisht vendimin e gjykatës së apelit me argumente të njëanshme, me qëllimin e vetëm për ta deklaruar fajtor kërkuesin, megjithëse argumentet e paraqitura në rekurs ishin logjike, ligjore, shteruese dhe të bazuara në të drejtën kushtetuese e procedurale. Po ashtu, edhe provat duhet të shqyrtoheshin dhe vlerësoheshin sipas rregullave procedurale dhe jo sipas pikëpamjes subjektive të gjykatës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

12. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Kolegji çmon të theksojë se kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, Kolegji mund të verifikojë një ose më shumë prej këtyre kritereve, pa qenë i detyruar të ndjekë një radhë të paracaktuar të analizës. Mospërmbushja e njërit prej tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Në rastin konkret, duke pasur parasysh natyrën dhe përmbajtjen e pretendimeve të kërkuesit, Kolegji do të ndalet në verifikimin e plotësimit të kriterit *ratione materiae* dhe, në vijim, në bazueshmërinë e tyre në aspektin kushtetues.

14. Sipas kërkuesit, Gjykata e Apelit Shkodër i ka cenuar të drejtën për mbrojtje efektive dhe barazinë e armëve, pasi ka revokuar mbrojtësin e zgjedhur prej tij, avokatin G.Y., dhe ka caktuar mbrojtës kryesisht për shkak të kërkesave të paraqitura gjatë gjykimit. Sipas tij, avokati ka qenë i pranishëm në seanca dhe nuk ka hequr dorë nga mbrojtja, ndërsa kërkesat e paraqitura për përjashtimin e gjyqtares nuk kanë qenë abuzive, për rrjedhojë revokimi i mbrojtësit ka qenë i pambështetur në ligj.

15. E drejta e mbrojtjes në procesin penal garantohet nga neni 31, shkronja "ç", i Kushtetutës. Gjykata ka pranuar se kjo e drejtë ka përmbajtje substanciale dhe duhet të ushtrohet realisht dhe efektivisht. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin masat ligjore që i mundësojnë individit mbrojtjen, në respektim të barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 73, datë 14.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në lidhje me të drejtën e mbrojtjes, GJEDNJ-ja ka theksuar se i akuzuari duhet të ketë mundësinë të përfitojë nga ndihma juridike e zgjedhur prej tij dhe se kjo e drejtë duhet të jetë praktike dhe efektive. Kur mbrojtësi nuk e përmbush detyrën e tij, autoritetet duhet të marrin masa për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes (*shih Balliu kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 74727/01, datë 16.06.2005, §§ 32–35 dhe § 37*).

17. Për këtë pretendim të kërkuesit, Kolegji Penal ka vlerësuar se gjykata e apelit kishte disponuar përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, me qëllim që kërkuesi të ballafaqohej me provat, veçanërisht me dëshmitarët, duke i krijuar mundësinë dhe kohën e nevojshme për realizimin e mbrojtjes. Ai kolegj ka konstatuar se gjykimi ishte shtyrë në disa seanca për shkak të mbrojtësit të zgjedhur, i cili paraqiste në mënyrë të përsëritur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares V.V., të shqyrtuara dhe të rrëzuara si të pabazuara në prova dhe në ligj. Sipas atij kolegji, gjykata e apelit e kishte barazuar këtë sjellje me braktisjen *de facto* të mbrojtjes dhe kishte vijuar gjykimin pa mbrojtësin e zgjedhur, duke i caktuar kërkuesit mbrojtës kryesisht, pasi kërkesat e përsëritura kishin sjellë shtyrjen e seancave dhe ishin vlerësuar si pengesë për ecurinë e

procesit. Ndërkohë, sipas Kolegjit Penal, kërkuesi kishte pasur mundësi të kundërshtonte provat, të pyeste dëshmitarët e akuzës dhe të paraqiste prova e dëshmitarë në mbështetje të alibisë së tij. Në këto rrethana, në vlerësimin e Kolegjit Penal nuk rezulton që caktimi i mbrojtësit kryesisht ta ketë privuar kërkuesin nga një mbrojtje reale dhe efektive.

18. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se zëvendësimi i mbrojtësit të zgjedhur ka ardhur si pasojë e kërkesave të përsëritura të tij për përjashtimin e gjyqtares V.V., të cilat kishin sjellë shtyrjen e seancave dhe ishin vlerësuar si pengesë për ecurinë e procesit. Në këto rrethana, caktimi i mbrojtësit kryesisht është bërë për të siguruar vijimin e gjykimit dhe ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes. Nga ana tjetër, kërkuesi ka pasur mundësi të kundërshtojë provat, të pyesë dëshmitarët e akuzës dhe të paraqesë prova në favor të tij. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se zëvendësimi i mbrojtësit të zgjedhur nuk e ka privuar kërkuesin nga një mbrojtje reale dhe efektive, ndaj pretendimi i tij është haptazi i pabazuar.

19. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, për shkak të mënyrës sesi gjykata e apelit ka vlerësuar provat dhe Gjykata e Lartë u është përgjigjur shkaqeve të rekursit për këtë çështje. Ai ka pretenduar se dëshmitarët nuk e kanë identifikuar si autor në deklarimet e para pas ngjarjes dhe se deklarimet e dëshmitares N.Rr. bien në kundërshtim me aktin e ekspertimit balistik. Sipas tij, gjykata e apelit e ka mbështetur vendimin, në thelb, në një provë të vetme, në kundërshtim me provat e tjera, pa u provuar fajësia përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

20. Parimi i prezumimit të pafajësisë parashikohet në nenin 30 të Kushtetutës, sipas të cilit kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ky parim kërkon që gjykatat e zakonshme të mos e fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Asnjë dënim ose masë që barazohet me të nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 12, datë 24.08.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Ndërsa për sa i takon arsyetimit të vendimit gjyqësor Gjykata ka theksuar se ai është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i arsyetimit është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Detyrimi për arsyetim ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit (shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese). Vendimet

për mospranimin e rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit dhe se ky arsyetim nuk cenon standardet kushtetuese përderisa në thelb shpreh vlerësimin e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit (shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Po në këtë drejtim, Gjykata ka pranuar se ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë, ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë e ka marrë në shqyrtim pretendimin se gjykata e apelit kishte cenuar nenin 152 të KPP-së, duke e mbështetur vendimin, në thelb, në një provë të vetme. Kolegji Penal ka arsyetuar se në rigjykimin në apel provat ishin marrë e verifikuar në seancë gjyqësore dhe i ishin nënshtruar debatit gjyqësor. Sipas tij, gjykata e apelit i kishte analizuar provat në tërësi dhe në lidhje me njëra-tjetrën, pa i dhënë vlerë të paracaktuar asnjërës prej tyre. Ai ka evidentuar se deklarimet e dëshmitarëve kishin luajtur rol vendimtar në identifikimin e autorit, por ishin vlerësuar në raport me provat e tjera dhe indiciet. Gjykata e Lartë ka vlerësuar gjithashtu se gjykata e apelit u kishte dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të mbrojtjes.

23. Për alibinë e kërkuesit Kolegji Penal ka gjetur të drejtë arsyetimin e gjykatës së apelit se ajo nuk ishte paraqitur në deklarimet e viteve 1997, 1998 dhe 2000, ndërsa pas vdekjes së shtetasit S.B. vrasja i ishte atribuuar atij, në kundërshtim me deklarimet e mëparshme të dëshmitarëve të fisit Bardhoshi. Sipas Kolegjit Penal, gjykata e apelit i ka analizuar këto deklarime në raport me provat e tjera të administruara dhe u ka dhënë përgjigje pretendimeve të mbrojtjes lidhur me alibinë e kërkuesit.

24. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje shkaqeve të rekursit për mënyrën e vlerësimit të provave dhe provimin e fajësisë. Nga arsyetimi i saj nuk rezulton që përfundimi për fajësinë të jetë mbështetur në një provë të vetme ose që provave t'u jetë dhënë vlerë e paracaktuar. Po kështu, nga argumentet e kërkuesit nuk rezulton zhvendosje e barrës së provës tek ai ose përcaktim i fajësisë mbi bazën e aludimeve ose dyshimeve. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, është haptazi i pabazuar.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.